KËRKESË
Nr.4451, datë 1.10.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Kulturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit "Ndërhyrje të përkohshme rehabilituese në sheshin "Nënë Tereza"".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria Rajonale e KulturësKombëtare Durrës. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Kulturës.

Vlera totale e shpronësimit është 9 203 086 (nëntë milionë e dyqind e tremijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekësh.

Lista

1.Zona kadastrale 8280 me nr.pasurie 2/335, në pronësi të Ornela Mansaku.

MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro

SHPRONËSIM I PËRKOHSHËM PËR INTERES PUBLIK, TË CILAT PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "NDËRHYRJE TË PËRKOHSHME DHE REHABILITUESE NË SHESHIN "NËNË TEREZA""

Nr.	**Pronari**	**Zona kadastrale**	**Nr.pasurie**	**Sipërfaqe**		**Çmimi lekë/m²**		**Vlera lekë**			**Shënime**
				Truall	**Ndërtim**	**Truall**	**Ndërtim**	**Truallit**	**Ndërtesë**	**Banesë**	
1.	Ornela Mansaku	8280	2/335	135.0	135.0	23,955.0	44,216.007	3,233,925	5,969,161		Kartela e pasurisë
				135	**135.0**			**3,233,925**	**5,969,161**	**-**	**9,203,086**
	TOTALI			**lekë**							